



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-063

Prishtinë, më 13 qershor 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 13 QERSHOR 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Avni Bytyçi dhe Driton Lajçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,
Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe
Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të Kryesisë, të mbajtur më 3 qershor 2016,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 3 qershor 2016

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 3 qershor 2016.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës:

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishëm në mbledhje, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 16 qershor 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Votimi i Projektligjit nr. 05/L-098 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10,
5. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave,
6. Zgjedhja e Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-081 për Energjinë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-082 për Gazin Natyror
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës,
14. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015,
15. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015,
16. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015,
17. Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016

Kryesia raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016 e shtyu për mbledhjen e radhës.

2. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitet 2017-2019, në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave 2017/01

Kryesia, pasi e shqyrtoi Rekomandimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017-2019, sipas rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

2. I rekomandohet Ministrisë së Financave që kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të përgatitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, t'i përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017-2019.

3. Njoftimi i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Kroaci

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Kroaci, nga 15-18 maj 2016.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale